

# BULETINI



KORRIK 2024



## OJQ ACDC mbajti Konferencën për Liberalizimin e Vizave për Kosovën

Më 10 korrik, OJQ ACDC organizoi një konferencë mbi ndikimin e forcimit të fushatës ekzistuese të ndërgjegjësimit për liberalizimin e vizave, me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Konferenca prezantoi rezultatet e përpjekjeve për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve nën regjimin pa viza. Ajo u fokusua në ndikimin e iniciativave informuese, duke përfshirë sesionet informative, fushatat e mediave sociale dhe shpërndarjen e materialeve edukative. Konferenca gjithashtu theksoi interesin e shtuar për pasaportat e Kosovës si një nga efektet e dukshme të liberalizimit të vizave.

### Mbulimi mediatik:





## ACDC dhe Komisioneri i Informacionit nënshkruajnë Memorandumin


Komisioneri për Informacionin dhe Privatësinë, Krenare Sogojevë Dërmaku, dhe Drejtori Ekzekutiv i ACDC, Dushan Radaković, nënshkroi Memorandumin e Bashkëpunimit, me qëllim ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve në veri të Kosovës dhe AIP-së, si dhe lehtësimin e qasjes së qytetarëve në shërbimet e AIP-së në rajonet tjera të Kosovës.



## Ekipi i ACDC rrit njohuritë mbi mbrojtjen nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual



Në korrik, ekipi i ACDC, së bashku me partnerë të tjerë zbatues, morën pjesë në dy sesione të rëndësishme trajnimi të fokusuara në Mbrojtjen nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (PSEA). Këto sesione dhanë njohuri të vlefshme për të kuptuar politikat që lidhen me PSEA, pasojat e shfrytëzimit seksual, abuzimit (SEA) dhe ngacmimit seksual. Pjesëmarrësit gjithashtu mësuuan se si të identifikojnë dhe raportojnë në mënyrë efektive incidentet dhe si të ofrojnë mbështetjen dhe referimet e nevojshme për viktimat e dhunës.





## ACDC dhe REC organizojnë vizitë të të rinjve në Prizren



Në bashkëpunim me OJQ-në REC, u organizua një vizitë në objektet fetare dhe kulturore në Prizren . Qëllimi i kësaj vizite ishte promovimi i multikulturalizmit tek të rinjtë e komuniteteve të ndryshme.

Ky aktivitet u realizua në kuadër të një projekti të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë dhe po zbatohet nga OJQ REC në partneritet me OJQ ACDC.

## OJQ ACDC mori pjesë në seminarin mbi Strategjinë e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile

Zyrtari i Programit të OJQ ACDC, Miljan Vanic, mori pjesë në një seminar të organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, me fokus në zhvillimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2024-2029. Punëtorja prezantoi draftin e parë të objektivave të strategjisë dhe synonte krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm për shoqërinë civile dhe qytetarinë aktive. Kjo ngjarje u mbështet nga Platforma Civikos dhe projekti TACSO-3.



**Duke filluar nga korriku, OJQ ACDC do të nisë tre projekte të reja:**

## **Shërbimet e Informimit Publik dhe Vetëdijesimit për Komunitetet e Cënueshme në Kosovë (PIAKOS)**

Në partneritet me SHPRK dhe INJECT, dhe nën udhëheqjen e ATRC-së, kjo iniciativë do të angazhojë 600 familje në veri të Kosovës për të përmirësuar të kuptuarit e tyre për të drejtat pronësore, ndihmën juridike dhe stimulimet tatimore. Projekti synon të fuqizojë komunitetet e cënueshme duke ofruar informacion thelbësor për t'i ndihmuar ata të lundrojnë me besim në proceset që lidhen me pronën. Është publikuar edhe një thirrje publike, e cila fton vullnetarët të marrin pjesë në një fushatë derë më derë si pjesë e kësaj nisme.



## **Kampet verore multietnike: Lidhja përmes gjuhëve dhe kulturës**



Si pjesë e projektit YESS të financuar nga Fondi për Ndërtimin e Paqes të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, ACDC, në bashkëpunim me IOM dhe UNICEF, do të organizojë kampe verore për fëmijët e moshës 13 deri në 18 vjeç me prejardhje të ndryshme etnike. Këto kampe do të nxisin mirëkuptimin, unitetin dhe ndjeshmërinë ndërkulturore përmes programeve dhe aktiviteteve të ndryshme. Duke bashkuar të rinjtë, kampet synojnë të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme dhe të frymëzojnë nisma për ndërtimin e paqes.



## **Lehtësimi i bashkëpunimit ndëretnik përmes monitorimit dhe raportimit të rasteve të krimeve të luftës**

Partneritet me Internews Kosova, ACDC do të kontribuojë në drejtësinë tranzicionale duke monitoruar seancat gjyqësore të krimeve të luftës në Kosovë. Ky projekt synon të rrisë ndërgjegjësimin e institucioneve gjyqësore dhe publikut përmes monitorimit të gjykatave dhe raportimit gazetaresk, duke theksuar rëndësinë e adresimit të krimeve të luftës për pajtim. Dy artikuj në lidhje me këtë projekt janë publikuar në faqet e ACDC dhe Kallxo dhe mund të lexohen [\[KETU\]](#).



## OJQ ACDC publikon deklaratë për emërimet e noterëve në Kosovë

Më 17 korrik është lëshuar një deklaratë publike e shoqërisë civile lidhur me emërimin e noterëve në Kosovë. Në deklaratë shprehet shqetësimi dhe protesta për vendimin e ministrit të Drejtësisë së Kosovës për emërimin e noterëve, ku në mesin e 100 noterëve të emëruar nuk ka asnjë noter nga komuniteti serb.



SRB



ENG



ALB

### Dushani Radaković në Prezantimin e Raportit të BIRN-it në Kosovë për Drejtësinë Tranzicionale

Dushani Radaković, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së ACDC, mori pjesë në prezantimin e raportit të BIRN-it në Kosovë të titulluar "Tjetri që nuk ekziston" dhe u angazhua në diskutime rreth gjendjes aktuale të drejtësisë tranzicionale në Kosovë.



ACDC në media

Drejtori Ekzekutiv i OJQ-së ACDC, Dushan Radaković për Insajderin



Drejtori i Programit të OJQ-së ACDC, Aleksandar Rapajiq për Kosovo Online



Drejtori i Programit të OJQ-së ACDC, Aleksandar Rapajiq për Kosovo Online



Drejtori i Programit të OJQ-së ACDC, Aleksandar Rapajiq për EuroNews



Menaxheri i programit të OJQ-së ACDC, Slobodan Stošić për Kosovo Online

